



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data
14.12.2020

RELACION PËR PROJEKTVENDIMIN

PËR CAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT PËR ANËTARËT E KOMISIONEVE ZGJEDHORE NË ZGJEDHJET PËR KUVEND, TË DATËS 25 PRILL 2021

Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në bazë të kompetencës së parashikuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronja “n” dhe paragrafi 2, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për caktimin e masës së shpërblimit për anëtarët e komisioneve zgjedhore në zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021”.

Referuar nenit 29, paragrafi 3, të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përcakton me vendim masën e shpërblimit për punën që kryejnë anëtarët e komisioneve zgjedhore.

Projektvendimi në vlerësim të:

- kohëzgjatjes së funksionimit të administratës zgjedhore sipas nivelit përkatës;
- detyrat, përgjegjësitë dhe ngarkesën e punës sipas funksionit përkatës;
- detyrave të shtuara dhe procedurave të reja të komisionerëve zgjedhorë në përdorimin e teknologjisë së informacionit në zgjedhje.

parashikon masën e shpërblimit të anëtarëve të komisioneve zgjedhore, në vlerën:

- a) Kryetarin dhe zv.kryetarin e KZAZ-së në vlerën 75.000 (shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë.
- b) Sekretarin e KZAZ-së në vlerën 65.000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë.
- c) Anëtarin e KZAZ-së në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetëmijë) lekë.
- ç) Për kryetarin e KQV-së në vlerën 5.000 (pesëmijë) lekë.
- d) Për sekretarin e KQV-së në vlerën 4.500 (katërmijë e pesëqind) lekë.
- dh) Për anëtarin e KQV-së në vlerën 4.000 (katërmijë) lekë.
- e) Për anëtarin e GNV-së në vlerën 10.000 (dhjetëmijë) lekë.

Masa e shpërblimit të komisionerëve zgjedhorë për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, krahasuar me masën e shpërblimit për ta në zgjedhjet e mëparshme, është në vlerë të shtuar prej:

5000 lekë për Kryetarin dhe Zv.kryetarin e KZAZ;

1000 lekë për Kryetarin e dhe Sekretarin e KQV-së;

500 lekë për anëtarin e KQV-së;

4000 lekë për anëtarin e GNV-së.

Ana TENOLLI – Drejtoria e Komisioneve dhe Materialeve Zgjedhore

Madalena KOJA – Drejtoria Juridike dhe e Dokumentacionit Zgjedhor

Ylli MERKAJ – Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data:Dhjetor 2020

Nr:

PROJEKTVENDIM

PËR CAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT PËR ANËTARËT E KOMISIONEVE ZGJEDHORE NË ZGJEDHJET PËR KUVEND, TË DATËS 25 PRILL 2021

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronja “n” dhe paragrafi 2, nenin 29, paragrafi 3, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

V Ë R E N

Referuar nenit 29, paragrafi 3, të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përcakton me vendim masën e shpërblimit për punën që kryejnë anëtarët e komisioneve zgjedhore.

Referuar neneve 20 dhe 21 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ku përcaktohen kompetencat e Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve në mënyrë shteruese, nuk përcaktohet kompetenca për caktimin e masës së shpërblimit të komisionerëve zgjedhorë.

Referuar nenit 19, paragrafi 1, gërma”n”, të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioneri ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Komisioneri, për caktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të komisioneve zgjedhore, vlerëson kohëzgjatjen e funksionimit sipas nivelit të administratës zgjedhore, detyrat, përgjegjësitë dhe ngarkesën e punës sipas funksionit përkatës.

Referuar nenit 28, paragrafi 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor (KZAZ) ngrihet 90 ditë para datës së zgjedhjeve dhe do të jetë në detyrë deri në nxjerrjen e tabelës së rezultatit të zgjedhjeve të zonës së administrimit zgjedhor (ZAZ).

KZAZ përgjigjet për administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në ZAZ, duke ushtruar detyra të rëndësishme, ku ndër më kryesore janë emërimi i anëtarëve të Komisioneve të Qendrave të Votimit (KQV), shpërndarja e bazës materiale zgjedhore për këto komisione, kontrolli i punës dhe funksionimit të KQV-ve për zhvillimin e rregullt dhe të qetë të procesit të votimit, merr në dorëzim materialet e votimit nga KQV-të, kontrollon, drejton procesin e numerimit të votave dhe miraton me vendim tabelën përmbledhëse të rezultateve të zonës së administrimit zgjedhor.

Referuar nenit 36, paragrafi 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KZAZ emëron anëtarët e KQV-së në çdo rast jo më vonë se 20 ditë para datës së zgjedhjeve. Anëtarët e KQV-së përgjigjen për zhvillimin e zgjedhjeve në Qendrën e Votimit, duke zbatuar detyrat e parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe aktet nënligjore dalë në bazë e për zbatim të tij. Kryetari dhe Sekretari i KQV-së, janë përgjegjës për marrjen në dorëzim nga KZAZ të materialeve zgjedhore para datës së votimit, dhe dorëzimin e materialeve të votimit në Vendin e Numërimit të Votave pas mbylljes së votimit.

Referuar nenit 95, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KZAZ cakton Grupet e Numërimit të Votave (GNV) 10 ditë para datës së zgjedhjeve. Anëtarët e GNV-së kryejnë numërimin, vlerësimin e votave, nxjerrin rezultatin duke plotësuar tabelën e rezultatit për qendrën e votimit të numëruar.

Referuar nenit 179, paragrafi 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.04.2021, identifikimi elektronik i zgjedhësve do të shtrihet në 100 për qind të votuesve. Përdorimi i teknologjisë së informacionit në zgjedhje, do të shoqërohet me detyra dhe përgjegjësi të shtuara për komisionerët zgjedhorë.

PËR KËTO ARSYE:



Data: Dhjetor 2020

Nr.

Për caktimin e masës së shpërblimit për anëtarët e komisioneve zgjedhore në zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 19, paragrafi 1, gërma "n", dhe paragrafi 2, nenin 29, paragrafi 3, e vijues të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

VENDOS:

1. Të caktojë masën e shpërblimit për anëtarët e komisioneve zgjedhore që do të ngrihen për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, si më poshtë:
 - a) Kryetarin dhe zv.kryetarin e KZAZ-së në vlerën 75.000 (shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë.
 - b) Sekretarin e KZAZ-së në vlerën 65.000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë.
 - c) Anëtarin e KZAZ-së në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetëmijë) lekë.
 - ç) Për kryetarin e KQV-së në vlerën 5.000 (pesëmijë) lekë.
 - d) Për sekretarin e KQV-së në vlerën 4.500 (katërmijë e pesëqind) lekë.
 - dh) Për anëtarin e KQV-së në vlerën 4.000 (katërmijë) lekë.
 - e) Për anëtarin e GNV-së në vlerën 10.000 (dhjetëmijë) lekë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: Dhjetor 2020

Nr.

Për caktimin e masës së shpërblimit për anëtarët e komisioneve zgjedhore në zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021